

V E N D I M
Nr.16, datë 11.1.1993

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË REJA TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave e të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Transporteve dhe Komunikacioneve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.307, datë 20.7.1992 "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si vijon: "Tarifat e transportit qytetar të udhëtarëve në linjat me largësi deri në 9 km, por brenda periferisë së qytetit, caktohen 3 lekë për një vajtje ose kthim, 90 lekë për një biletë pajtimi mujor dhe 250 lekë për atë tremujore. Për nxënësit dhe studentët bileta e pajtimit mujor caktohet 45 lekë dhe e pajtimit tremujor 130 lekë".

b) Tarifat e përcaktuara në pikën 2 rriten mesatarisht dy herë ndaj atyre ekzistuese.

2. Tarifat e reja të transportit të miratuara sipas këtij vendimi, hyjnë në fuqi me 16 janar 1993, kurse çmimet e biletave të pajtimit më 1 shkurt 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku